

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dinamo kërkon fitoren e katërt radhazi ndaj Laçit/ Daja paralajmëron: Duhet të kemi kujdes në tranzicion
ADRESA	https://piranjat.al/sport/dinamo-kerkon-fitoren-e-katert-radhazi-ndaj-lacit-daja-paralajmeron-duhet--i104829
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:02:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 11:49:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a6f2655ef487290743d46a75fd3d6520ba8ee24c341f22115bdba7ab8c2c35e5
TEKSTI	45206b5fdf31ab4e005dcf3364dd6addee4bc66f85afceba2c62dfb4e0ea2b2b
PAMJA	7be958415a88de07133fb6cd492febf49d0d8495c795c88dd79bb911dac29e60

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	98ac94de79a3fc8a3acd4896c4b46cdc27a45a143de0d4d5286df904a607d9bb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/98ac94de79a3fc8a3acd4896c4b46cdc27a45a143de0d4d5286df904a607d9bb

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISSIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **dosja kaion** Agasin dhe ka **industri e mbrojtjes** vendimi presidencial të bo... **ne lokal, niset me helikopter** ndodhur mesditën e kësaj **ka 469 të burgosur!** ose Ndëshkimit Çnjerëzor **te bashkohemi** Kosovës, Jakup Krasniqi, të niithë

SPORT

Dinamo kërkon fitoren e katërt radhazi ndaj Laçit/ Daja paralajmëron: Duhet të kemi kujdes në tranzicion

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 13:49



Dinamo synon të vijojë serinë e rezultateve pozitive në Abissnet Superiore, teksa këtë javë përballlet me Laçin në "Elbasan Arena", në kuadër të javës së pestë të kampionatit.

Blutë vijnë në këtë sfidë pas tri fitoreve radhazi dhe me moral të lartë, ndërsa objektivi i skuadrës së Ilir Dajës është ta mbyllë këtë fazë të kampionatit përpara pauzës me një tjetër rezultat pozitiv.

Përballë do të jetë Laçi, i cili gjithashtu po kalon një moment të mirë dhe ka grumbulluar shtatë pikë.

Në prag të sfidës, Daja e ka vlerësuar kundërshtarin dhe ka paralajmëruar një përballje të fortë, ku Dinamo do të kërkojë të imponojë lojën e saj.

"Përpara kemi një ndeshje që do të jetë e bukur dhe shumë e luftuar nga të dyja skuadrat, të cilat vijnë nga një moment pozitiv. Ne kërkojmë vazhdimësinë e rezultateve pozitive, duke qenë se vijmë pas tri fitoreve radhazi, ashtu si edhe Laçi, që nuk është mbrapa, duke parë se ka grumbulluar shtatë pikë", u shpreh trajneri.

Daja theksoi se skuadra e tij duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme në momentet kur Laçi kalon në tranzicion.

"Do të jetë një ndeshje e luftuar në maksimum. Ne do të kërkojmë të imponojmë lojën tonë, por duhet të kemi gjithashtu kujdes me ekuilibrat në prapavijë, sepse Laçi është një skuadër që del mirë në tranzicion", deklaroi ai.

Trajneri foli edhe për situatën e grupit, duke bërë të ditur se gjatë kësaj jave skuadra nuk ka qenë e plotë për shkak të disa dëmtimeve dhe shqetësimeve muskulore.

"Këtë javë kemi pasur një proces stërvitor gjatë të cilit nuk e kemi pasur të gjithë grupin në dispozicion, për shkak të disa dëmtimeve dhe shqetësimeve muskulore. Megjithatë, besoj se me kontingjentin tashmë të zgjeruar që kemi në dispozicion do të jemi të kompletuar", tha Daja.

Sipas tij, zgjerimi i grupit i jep stafit teknik më shumë alternativa për menaxhimin e gjendjes fizike të futbollistëve dhe për të bërë rotacionin e nevojshëm.

"Një grup më i zgjeruar na jep mundësinë që t'i rikuperojmë siç duhet lojtarët që nuk do të jenë të pranishëm, ashtu siç na krijon mundësinë të bëjmë edhe rotacion për ndonjë lojtar që nuk ka qenë në gjendjen më të mirë fizike."

Daja shtoi se Dinamo ka pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e sfidës dhe se skuadra do të kërkojë maksimalisht tri pikë.

"Kemi pasur të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion për ta përgatitur ndeshjen dhe besoj se nesër do ta vlerësojmë siç duhet Laçin, në mënyrë që të vazhdojmë me rezultatet pozitive."

Në fund, trajneri i Dinamos iu drejtua edhe tifozëve, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së tyre nga shkallët e stadiumit.

"Prania e tifozëve i jep tjetër bukuri ndeshjes dhe ne kemi gjithmonë nevojë për ta. Besoj se, me këtë start të kampionatit, tifozët tanë do të jenë të pranishëm për të na mbështetur", u shpreh Daja.

Kjo do të jetë ndeshja e fundit e Dinamos nënpara ngritjes trajneri të kampionatit e cila vlen për shkak të angazhimeve të ekipeve kombëtare. Blutë synojnë ta mbyllin këtë periudhë me një tjetër

fitore dhe të ruajnë ecurinë pozitive të javëve të fundit.

Artikuj te sugjeruar

SPORT 18 Shtator13:37

[Pa kontratë, por ende në klub: Paul Pogba nuk është gati t'i varë këpucët në gozhdë](#)

Duke ndjekur gjithmonë nga afër lajmet e ekipit kombëtar francez, me të cilin mban një lidhje të veçantë, Paul Pogba...

SPORT 18 Shtator13:11

[Spanja, rikthime dhe mungesa, De la Fuente publikon listën](#)

Në Spanjë, ndryshimet janë me "pikatore", me trajnerin De la Fuente që i beson të njëjtit grup që në 4 vit...

SPORT 18 Shtator13:07

[Dy filozofi të ndryshme, Roma-Inter, ose mbrojtja kundër sulmit më të mirë](#)

Roma dhe Interi përballen në një duel që premtan spektakël, mes dy skuadrave që kanë nisur sezonin me pikë t&eum...

SPORT 18 Shtator12:25

[Rikthime të rëndësishme, Tuchel thërret Palmer e Arnold, lë jashtë Watkins](#)

Thomas Tuchel ka bërë publike listën e Anglisë për ndeshjet e ardhshme në UEFA Nations League, në grumbullimin e tij të...

SPORT 18 Shtator11:47

[Kosova nuk gjen qetësi, pas Rrahmanit nga "Dardanët" njofton largimin edhe Hadërgjonaj](#)

Kosova nuk po kalon aspak një moment të qetë. Sikur të mos mjaftonin trazirat politike të shkaktuara nga vendimi i Gjykatës Spec...

SPORT 18 Shtator08:21

[Mourinho i beson sërish Viniciusit, braziliani pritet titullar ndaj Atletico Madridit](#)

Vinicius Junior pritet të jetë sërish në formacionin titullar të Real Madridit për derbin e së dielës ndaj Atletico Ma...

SPORT 18 Shtator08:10

[Zyrtare/ Panathinaikos huazon Aidon Shehun, ylli i Shqipërisë U-21 ndryshon ekip](#)

Aidon Shehu ka ndryshuar ekip në Greqi, teksa Panathinaikos ka vendosur ta huazojë te Pyrgos, skuadër që militon në Superligën 2...

SPORT 18 Shtator08:07

[Europa League pas ndeshjeve të para, Juventusi në krye!](#)

Njihuni me përfundimet dhe renditjen e Europa League, pas ndeshjeve të para: Omonia-Celta 1-0 (88' Balkovec) Ararat Armenia-Slavia Praga 1-4...

SPORT 17 Shtator23:10

[Juventusi del nga vetja, shënon pesë herë në Evropë](#)

Juventusi e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën në Ligën e Evropës, duke shënuar fi...

SPORT 17 Shtator20:34

[Futbolli shqiptar në zi/ Ndahet nga jeta ish-futbollisti i Vllaznisë e Kombëtares](#)

Futbolli shqiptar është përfshirë nga zia këtë të enjte pas ndarjes nga jeta të Esat Bushatit, një prej emrave t&eu...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 17 Shtator

[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetë...](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...](#)

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

BOTA 17 Shtator

[I veshur si grua, 33-vjeçari 'tradhtohet' dhe a...](#)

Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranëum...


video



E premte | 20:45 | Syri TV



E premte | 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.